

VENDIM
Nr.118, datë 23.7.2007

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, TË NJË MJEDISI NË
PRONËSI TË RADIO TELEVISIONIT PUBLIK SHQIPTAR AGJENCISË TELEGRAFIKE
SHQIPTARE**

Në mbështetje të neneve 2 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 7, 64 dhe 147 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.440, datë 1.6.2000 të Kuvendit “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)” dhe të neneve 11 dhe 12 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, pas dhënies/marrjes së pëlqimit paraprak të Këshillit Drejtues të RTSH-së,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënie në përdorim, pa kundërshtpërblim, të mjediseve të godinës në pronësi të Radio Televizionit Publik Shqiptar, sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, Agjencisë Telegrafike Shqiptare, si mjedise pune për ushtrimin e veprimtarisë për një afat të pacaktuar.

II. Në kontabilitetin e RTSH-së të pasqyrohet dhënia në përdorim, pa kundërshtpërblim, pa afat të caktuar, e mjediseve të përcaktuara në pikën I të këtij vendimi.

III. Shpenzimet që do të kryhen për rikonstruksionin e mjediseve të përcaktuara në pikën I të këtij vendimi, të përballohen në emër dhe për llogari të Buxhetit të Shtetit. Ato janë të pakompensueshme nga Radio Televizionit Publik Shqiptar.

IV. Ngarkohet Drejtori i Përgjithshëm i Radio Televizionit Publik Shqiptar dhe Drejtori i Agjencisë Telegrafike Shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

